



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë **21.03.2017**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor Aerodrom.

Vizita u realizua në përputhje me mandatin të cilin e ka Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) i përcaktuar në Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, me qëllim të përcaktimit real, përkatësisht gjendjes dhe kushteve objektive në këtë Stacion policor, në drejtim të identifikimit të rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Vizita në SP Aerodrom filloi me bisedën me ndihmës komandantin e Stacionit policor, të cilit iu prezantua mandati dhe kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional, u realizua këqyrja në hapësirat zyrtare dhe ndihmëse, këqyrja në dosjet individuale të personave të arrestuar dhe të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, si dhe në regjistrat të cilët udhëhiqen në stacionin policor (Regjistri për ngjarje ditore, për persona të thirrur, të arrestuar, privuar dhe ndaluar, Regjistri për përdorimin e mjeteve të forcës dhe Regjistri për parashtresa dhe ankesa nga qytetarët).

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional shpreh shqetësimin e tij serioz për shkak të mënyrës me të cilën komandanti i këtij stacioni policor e ka pamundësuar fotografimin e zyrave zyrtare në SP Aerodrom, e që gjatë praktikës së vendosur deri më tani nuk ka pasur asnjëherë problem të këtillë.

Në hyrje të SP Aerodrom është vendosur një sënduk i posaçëm i Sektorit të Punëve të Brendshme dhe Standarde Profesionale për parashtresa dhe ankesa nga qytetarë kundër veprimit të nëpunësve policorë.

Gjatë vizitës, nga ana e ekipit të MPN-së, nuk u vërejtën sende në hapësirat zyrtare të Stacionit policor, të cilat do të mund të përdreshin për dhunë ose frikësim.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP Aerodrom zbatohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për të punësuarit në SP Aerodrom edhe atë me përmbajtje tematike nga më të ndryshmet.

Ekipi i MPN vuri në dukje se në hyrje të SP Aerodrom nuk ka rampë për akses të personave me aftësi të kufizuar, me çka këtyre personave u vështirësohet qasja në stacionin policor.

Gjithashtu, Stacioni policor ballafaqohet me mungesë të nëpunësve policorë dhe me mungesë të automjeteve zyrtare.

Në Stacionin policor Aerodrom nuk ka hapësirë të posaçme për zhvillimin e bisedave me personat e mitur, si dhe nuk ka as hapësirë të posaçme për marrje në pyetje të personave, ndërsa ndalimi i personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria bëhet në hapësirat të cilat nuk i përmbushin kushtet minimale për ndalimin e personave.

Në këtë SP nuk ka tualete, kështu që përdoret tualeti i përbashkët, nga ana e personave zyrtarë dhe personave të privuar nga liria/palët.

Ekipi i MPN-së konstatoi se ky Stacion policor në Regjistrat e evidencës ka mangësi sa i përket plotësimit të një pjese të rubrikave.

Për këtë vizitë Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe adresoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te komandanti i Stacionit Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e konstatuara dhe të përmirësohen kushtet sa i përket trajtimit të personave të privuar nga liria dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.